LIGJ
Nr. 144/2014

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË GARANCISË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (BERZH) PËR MARRËVESHJEN E HUAS NDËRMJET AGJENCISË SHQIPTARE TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM PËR LINJËN E KREDISË PËR AGJENCINË SHQIPTARE TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për marrëveshjen e huas ndërmjet Agjencisë Shqiptare të Sigurimit të Depozitave dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim për linjën e kredisë për Agjencinë Shqiptare të Sigurimit të Depozitave, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.10.2014

Shpallur me dekretin nr. 8782, datë 12.11.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

(Numri i operacionit 45446)

MARRËVESHJE GARANCIE

PËR LINJËN E KREDISË PËR AGJENCINË SHQIPTARE TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Marrëveshje Garancie e datës _____ 2014 ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (Garantuesi) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka) (Marrëveshja e Garancisë).

PREAMBULË

Duke marrë në konsideratë se Garantuesi dhe Agjencia Shqiptare e Sigurimit të Depozitave kanë kërkuar asistencë nga Banka për financimin e një pjese të Projektit;

duke marrë në konsideratë se në pajtim me një marrëveshje huaje të së njëjtës datë ndërmjet Agjencisë Shqiptare të Sigurimit të Depozitave dhe Bankës ("Marrëveshja huas", siç përcaktohet në Termat dhe Kushtet Standarde, Banka ka rënë dakord të hapë një linjë kredie për Huamarrësin në shumën 100 milionë euro, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara ose të përmendura në Marrëveshjen e Huas, por

vetëm me kushtin që Garantuesi të garantojë detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huas sipas parashikimit në këtë Marrëveshje; dhe

duke marrë në konsideratë se Garantuesi, për sa i takon lidhjes së Marrëveshjes së Huas ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit, ka rënë dakord të garantojë këto detyrime të Huamarrësit.

rrjedhimisht, palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Termat dhe Kushtet Standarde; përkufizime

Seksioni 1.01. Përfshirja e Termave dhe Kushteve Standarde

Të gjitha dispozitat e Termave dhe Kushteve Standarde të Bankës të datës 1 dhjetor 2012 përfshihen dhe bëhen të zbatueshme për këtë Marrëveshje me të njëjtin efekt dhe fuqi sikur të ishin parashikuar këtu (këto dispozita quhen më poshtë "Termat dhe Kushtet Standarde").

Seksioni 1.02. Përkufizime

Kudo që përdoren në këtë Marrëveshje (duke përfshirë preambulën), përveç kur deklarohet ndryshe ose konteksti e kërkon ndryshe, termat e përkufizuara në preambulë kanë kuptimet përkatëse që u jepen atyre këtu; termat e përkufizuara në Termat dhe Kushtet Standarde dhe Marrëveshjen e Huas kanë kuptimet e tyre përkatëse të dhëna atyre këtu dhe termi i mëposhtëm ka kuptimin e mëposhtëm:

"Përfaqësues i autorizuar i Garantuesit" është Ministri i Financave i Garantuesit.

Seksioni 1.03. Interpretimi

Në këtë Marrëveshje, një referencë në një nen ose seksion të caktuar, përveç kur përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshje, interpretohet si referencë në atë nen ose seksion të specifikuar të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Garancia dhe procedura

Seksioni 2.01. Garancia

Garantuesi garanton në mënyrë të pakushtëzuar, si i detyruar kryesor dhe jo thjesht si dorëzanë, pagesën e duhur dhe në kohë të çdo shume sipas Marrëveshjes së Huas, qoftë në afatin e caktuar të maturimit, të përshpejtuar apo ndryshe, dhe përmbushjen në kohë të të gjitha detyrimeve të tjera të Huamarrësit, të gjitha siç janë përcaktuar në Marrëveshjen e Huas.

Seksioni 2.02. Procedura

a) Garantuesi konfirmon që ka njohuri për termat dhe kushtet e Marrëveshjes së Huas.

b) Banka bie dakord që çdo kërkesë për pagesë për Garantuesin sipas kësaj Marrëveshjeje të bëhet me shkrim dhe kjo kërkesë për pagesë të specifikojë shumën e mbetur sipas Marrëveshjes së Huas dhe që duhet paguar nga Garantuesi, datën brenda së cilës shuma duhet të paguhet nga Garantuesi, e cila do të jetë një datë jo më pak se tre ditë pune nga data e njoftimit të kërkesës.

Neni 3

Të ndryshme

Seksioni 3.01. Njoftimet

Adresat e mëposhtme specifikohen për qëllimet e seksionit 10.01 të Termave dhe Kushteve Standarde:

Për Garantuesin:

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë
Ministria e Financave
Nr. 3, bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë

Shqipëri

Në vëmendje të: Ministri i Financave
Faks: +355 42228494

Për Bankën:
Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
One Exchange Square
London EC2A 2JN
United Kingdom

Në vëmendje të: Njësia e Administrimit të Operacioneve
Faks: +44-20-7338-6100

Seksioni 3.02. Opinioni ligjor

Për qëllimet e seksionit 9.03(b) të Termave dhe Kushteve Standarde dhe në pajtim me kushtet e Marrëveshjes së Huas, opinioni ose opinionet e këshilltarëve jepen në emër të Garantuesit nga Ministri i Drejtësisë. Formulari i këtij opinion i bashkëlidhet Marrëveshjes.

Në dëshmi të kësaj, Palët, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar rregullisht, kanë realizuar nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje në katër kopje dhe është shpallur në Tiranë në ditën dhe vitin e shkruar më sipër.

KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Nga:
Emri:

Titulli: Ministri i Financave

BANKA EVROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga:
Emri:
Titulli:

SHTOJCË
FORMULARI I OPINIONIT LIGJOR TË GARANTUESIT
(Koka zyrtare e letrës së Ministrisë së Drejtësisë)

Banka Europiane për
Rindërtim dhe Zhvillim
One Exchange Square
London EC2A 2JN
England

(Datë)

Zonja dhe zotërinj,

Lënda: Opinion ligjor mbi Marrëveshjen e Garancisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Marrëveshjen e

Huas ndërmjet Agjencisë Shqiptare të Sigurimit të Depozitave dhe Bankës Evropiane për rindërtim dhe Zhvillim, të dyja të datës ( ); (operacioni nr. 45446).

Më ( ) 2013 Agjencia Shqiptare e Sigurimit të Depozitave (Huamarrësi) dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka) lidhën një marrëveshje huaje (Marrëveshja e Huas) dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (Shteti) dhe Banka lidhën një marrëveshje garancie nëpërmjet së cilës Shteti garanton detyrimet e Huamarrësit në favor të Bankës (Garancia).

Në këtë Opinion, fjalët dhe shprehjet e përkufizuara në Marrëveshjen e Huas kanë të njëjtat kuptime.

Në cilësinë time si Ministër i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë, unë kam këqyrur kopjen e nënshkruar të secilës prej Marrëveshjes së Huas dhe Garancisë dhe të gjithë dokumentacionin tjetër, kam shqyrtuar Kushtetutën e Shqipërisë, së bashku me ligjet, rregulloret, dokumentet dhe të tjera dhe kam kryer hetime të tjera që i çmoj të nevojshme dhe të përshtatshme për qëllimet e këtij Opinioni. Bazuar në sa më sipër, unë jam i mendimit dhe deklaroj përkatësisht që:

a) Nëpërmjet (vendosni referencën tek autorizimi i Qeverisë (ose të një personi apo organi tjetër) të dhënë për përfaqësuesin e Huamarrësit që të negociojë dhe nënshkruajë Garancinë në emër të Republikës së Shqipërisë), Presidenca (ose një person apo organ tjetër të autorizuar) autorizon ( ) Ministrin e ( ), të lidhë dhe të nënshkruajë Garancinë në emër të Shtetit. Autorizimi i dhënë ( ) për të ndërmarrë këto veprime në emër të Shtetit, vazhdon të mbetet në fuqi të plotë në momentin e nënshkrimit të këtyre marrëveshjeve.

b) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (ose një person apo organ tjetër i autorizuar), pas shqyrtimit të projekteve të negociuara të Marrëveshjes së Huas dhe Garancisë, vendosi më (vendosni datën e aprovimit) të aprovojë këto projekte të Marrëveshjes së Huas dhe Garancisë.

c) Në pajtim me dispozitat e nenit 121 të Kushtetutës së Shtetit, negocimet dhe ratifikimet e traktateve i nënshtrohen vullnetit të Kuvendit Popullor të Shtetit.

d) Në pajtim me dispozitat e nenit 26 të ligjit nr. 9665, datë 18/12/2006 "Mbi huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë për huat shtetërore në Republikën e Shqipërisë", dhe neneve 117 dhe 121 të Kushtetutës së Shtetit, negocimi, nënshkrimi, shpallja dhe zbatimi i marrëveshjes së huas dhe lidhja e garancisë është dhënë pëlqimi nga Parlamenti i Shqipërisë në pajtim me (citoni ligjin e miratuar nga Parlamenti që ka dhënë pëlqimin e ratifikimit të Marrëveshjes së Huas).

e) Në pajtim me dispozitat e nenit ( ) të Kushtetutës së Huamarrësit, Marrëveshja e Huas dhe Marrëveshja e Garancisë u ratifikuan nga Presidenca më (vendosni datën), e provuar nga (vendosni titullin e instrumentit të ratifikimit).

f) Në pajtim me dispozitat e (vendosni ligjin përkatës), kërkesa në lidhje me publikimin e njoftimit të nënshkrimit, shpalljes, ratifikimit ose përmbushjes, apo në një aspekt tjetër, të Marrëveshjes së Huas dhe Garancisë, është përmbushur dhe është e pranueshme.

g) Në pajtim me dispozitat e (vendosni ligjin përkatës), kërkesat në lidhje me nënshkrimin, shpalljen dhe realizimin e Garancisë janë përmbushur dhe janë të pranueshme.

h) Të gjitha veprimet, kushtet dhe autorizimet që duhet të nënshkruhen, përmbushen dhe realizohen me qëllim që t'i mundësohet Shqipërisë, si Garantues, dhe Agjencisë Shqiptare të Sigurimit të Depozitave, si Huamarrës të lidhë, të ushtrojë të drejtat e saj dhe të përmbushë detyrimet e parashikuara në Marrëveshjen e Garancisë dhe Huas, përkatësisht janë përmbushur dhe realizuar në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe ligjet e Shqipërisë.

i) Detyrimet e Shtetit si Garantues dhe Agjencisë Shqiptare të Depozitave, si Huamarrës, siç janë parashikuar në Marrëveshjen e Garancisë dhe Huas, përkatësisht përbëjnë detyrime ligjore, të vlefshme dhe detyruese të Garantuesit dhe Huamarrësit dhe janë të ekzekutueshme në pajtim me kushtet e tyre përkatëse.

j) Detyrimet e shtetit të parashikuara në Garanci përmbajnë detyrime ndërkombëtare të Shtetit dhe janë aprovuar në pajtim me dispozitat e Kushtetutës së Shtetit në lidhje me marrëveshjet ndërkombëtare.

Së fundi, jeni të lutur të vini re që Shteti ka miratuar një ligj që i jep Bankës privilegje, imunitete dhe përjashtime pasi Shqipëria është anëtare e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Me respekt
Ministri i Drejtësisë
Republika e Shqipërisë

(Numri i operacionit 45446)

MARRËVESHJE HUAJE

LINJA E KREDISË PËR AGJENCINË SHQIPTARE TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
NDËRMJET AGJENCISË SHQIPTARE TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
_____2014

Marrëveshje e datës _____ 2014 ndërmjet Agjencisë Shqiptare të Sigurimit të depozitave (Huamarrësi) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka).

PREAMBULË

Duke marrë në konsideratë se Banka është themeluar për të dhënë financim për projekte të veçanta për të mbështetur kalimin drejt ekonomive të hapura të orientuara nga tregu dhe për të nxitur iniciativat private dhe sipërmarrëse në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore që u përkushtohen dhe zbatojnë parimet e demokracisë shumëpartiake, pluralizmit dhe ekonomisë së tregut;

duke marrë në konsideratë se Huamarrësi synon të zbatojë projektin e përshkruar në grafikun 1, i cili është i caktuar të asistojë Huamarrësin për gjetjen e fondeve për të përmbushur detyrimet e veta ndaj depozitave të siguruara (siç përkufizohet termi në këtë Marrëveshje) në pajtim me ligjin për sigurimin e depozitave në Shqipëri;

duke marrë në konsideratë se Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Huamarrësi kanë kërkuar asistencë nga Banka për financimin e një pjese të projektit;

duke marrë në konsideratë se në pajtim me një marrëveshje garancie me të njëjtën datë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë si Garantues dhe Bankës ("Marrëveshja e Garancisë", siç përkufizohet në Termat dhe Kushtet Standarde), Garantuesi ka garantuar detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

duke marrë në konsideratë se Banka ka rënë dakord në bazë të, ndërmjet të tjerash, sa më sipër t'i japë një hua Huamarrësit në shumën prej 100.000.000 euro, sipas termave dhe kushteve të parashikuara ose të përmendura në këtë Marrëveshje,

rrjedhimisht, palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1
Termat dhe Kushtet Standarde; përkufizime

Seksioni 1.01. Përfshirja e Termave dhe Kushteve Standarde

Të gjitha dispozitat e Termave dhe Kushteve Standarde të Bankës të datës 1 dhjetor 2012 përfshihen dhe bëhen të zbatueshme në këtë Marrëveshje me të njëjtin efekt dhe fuqi sikur të ishin parashikuar këtu, përveç kur nuk zbatohet Manuali i Disbursimit të BERZH-it (këto dispozita këtu quhen "Termat dhe Kushtet Standarde").

Seksioni 1.02. Përkufizime

Kudo që përdoren në këtë Marrëveshje (duke përfshirë preambulën dhe grafikët), përveç kur deklarohet ndryshe ose konteksti e kërkon ndryshe, termat e përkufizuar në preambulë kanë kuptimet përkatëse që u jepen atyre këtu; termat e përkufizuara në Termat dhe Kushtet Standarde kanë kuptimet e tyre përkatëse të dhëna atyre këtu dhe termat e mposhtëm kanë kuptimet e mëposhtme:

"Përfaqësuesi i autorizuar i Huamarrësit" është Drejtori i Përgjithshëm i Huamarrësit.

"Periudha e angazhimit" është periudha që fillon në datën e hyrjes në fuqi dhe që përfundon në datën e fundit të disponibilitetit ose në një datë të mëvonshme që Banka mund të vendosë pas marrjes paraprakisht të një kërkese me shkrim nga Huamarrësi (ku kjo kërkesë të kërkojë nëse ka Marrëveshje Garancie, të siglohet nga Garantuesi) dhe Banka njofton menjëherë Huamarrësin dhe Garantuesin për këtë datë të mëvonshme.

"Kërkesat e përcaktuara të performancës" janë kërkesat e performancës nga 1 deri në 8 dhe 10 (ose siç mund ta kërkojë konteksti, secila prej këtyre kërkesave të performancës) të kërkesave të performancës të muajit maj 2008 dhe që lidhen me politikën mjedisore dhe sociale të Bankës të muajit maj 2008.

"Vit fiskal" është viti fiskal i Huamarrësit që fillon më 1 janar të çdo viti.

"IFRS" janë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, të nxjerra ose miratuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit dhe që zbatohen në mënyrë të njëtrajtshme.

"Depozita të siguruara" janë "depozitat e siguruara në një bankë ose degë të saj" dhe "depozitat e siguruara tek SCA-ja", siç përkufizohen këto terma në LDI.

"Rast sigurimi" është kuptimi i dhënë këtij termi tek LDI-ja.

"Politikë investimi" është një politikë investimi që është aprovuar herë pas here formalisht nga bordi mbikëqyrës dhe/ose drejtues i Huamarrësit.

"Ligji për bankat" është ligji nr. 9662 i datës 18.12.2006, i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, i cili mund të ndryshohet herë pas here.

"Ligji për SCA-të" është ligji nr. 8782, datë 03/05/2001, i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, i cili mund të ndryshohet herë pas here.

"LDI" është ligji për sigurimin e depozitave nr. ( ), datë ( ) i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, i cili mund të ndryshohet herë pas here.{TË JEPET NGA DELEGACIONI PAS KALIMIT TË LIGJIT}.

"Institucion financiar anëtar" është një bankë ose një institucion tjetër financiar që është anëtar i skemës së sigurimit të depozitave të Huamarrësit dhe që ka kuptimin që i jepet termit "Anëtar subjekt i skemës së sigurimit të depozitave", tek LDI-ja.

"Statut" është statuti i Huamarrësit i cili mund të ndryshohet herë pas here.

Seksioni 1.03. Interpretimi

Në këtë Marrëveshje, një referencë në një nen, seksion ose grafik të caktuar, përveç kur përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshje, interpretohet si referencë në atë nen, seksion ose grafik të specifikuar të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2
Kushtet kryesore të Huas

Seksioni 2.01. Shuma dhe monedha

a) Banka bie dakord t'i japë hua Huamarrësit, sipas termave dhe kushteve të parashikuara ose të përmendura në këtë Marrëveshje, shumën prej 100.000.000 euro.

Seksioni 2.02. Terma të tjerë financiarë të Huas

a) Shuma minimale e tërheqjes është 8 milionë euro.

b) Shuma minimale e paradhënies është 8 milionë euro.

c) Shuma minimale e anulimit është 8 milionë euro.

d) Datat e pagesës së interesave janë 30 nëntor dhe 30 maj të çdo viti.

e) 1) Pas mbarimit të periudhës së angazhimit, çdo shumë e Huas e mbetur shlyhet nga Huamarrësi në këste të barabarta (ose sa më të barabarta që të jetë e mundur) gjysmëvjetore në çdo datë të pagesës së interesave të çdo viti, ku data e parë e shlyerjes së Huas është data e caktuar që përfaqëson datën e parë të pagesës së interesit që bie gjashtë muaj pas përvjetorit të pestë të kësaj Marrëveshjeje dhe data e fundit e shlyerjes së Huas është një datë e caktuar që bie në datën e parë të pagesës së interesit pas përvjetorit të dhjetë të kësaj Marrëveshjeje.

2) Pavarësisht nga sa më sipër, në rastin kur (i) Huamarrësi nuk e tërheq të gjithë shumën e Huas para datës së shlyerjes të Huas së specifikuar në Seksionin 2.02(e), dhe (ii) Banka e shtyn datën e fundit të disponibilitetit të specifikuar në seksionin 2.02(f) më poshtë në një datë që bie pas kësaj date të parë të shlyerjes së Huas, shuma e çdo tërheqjeje të bërë në ose pas datës së parë të shlyerjes së Huas alokohet për shlyerje në shuma të barabarta në disa data të shlyerjes së Huas që bien pas datës së kësaj tërheqjeje (ku Banka përshtat shumat e alokuara për të patur shifra të plota në çdo rast). Banka, herë pas here, e njofton Huamarrësin për këto alokime.

f) Data e fundit e disponibilitetit është data që bie në një datë të caktuar që përfaqëson përvjetorin e pestë të kësaj Marrëveshjeje, ose një datë tjetër të mëvonshme që Banka mund të vendosë, sipas diskrecionit të saj, pas marrjes së një kërkese paraprake me shkrim nga Huamarrësi (ku kjo kërkesë, nëse ka Marrëveshje Garancie, siglohet nga Garantuesi) dhe njofton Huama-rrësin dhe Garantuesin.

g) Norma e tarifës së angazhimit është (i) 0.5% në vit

h) Norma e komisionit të paguar paraprakisht është 0.5% e shumës principale maksimale të plotë të Huas (100.000.000 euro).

i) Huaja i nënshtrohet normës së ndryshue-shme të interesit.

Seksioni 2.03. Tërheqjet

a) Shuma e disponueshme mund të tërhiqet vetëm për qëllimet e caktuara në grafikun 1 dhe me ndodhjen e rastit të mëposhtëm:

i) "Rasti i sigurimit" siç përkufizohet në LDI.

b) Huamarrësi mund të kërkojë një disbursim, duke i paraqitur Bankës një kërkesë origjinale për një disbursim të tillë të nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar i Huamarrësit ose një person i caktuar nga ky përfaqësues i autorizuar në formularin e grafikut 3 dhe në përmbajtje të pranueshme për Bankën, të paktën 7 (shtatë) ditë pune para datës së propozuar për një disbursim të tillë. Një kërkesë e tillë, përveç kur Banka bie dakord ndryshe, është e parevokueshme dhe detyruese për Huamarrësin. Disbursimi do të përdoret ekskluzivisht për qëllimet dhe zbatohet për Projektin në pajtim me kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Ekzekutimi i projektit

Seksioni 3.01. Detyrime të tjera pohuese për projektin

Pa kufizuar përgjithësimin e seksioneve 4.02(a), 4.04(a)(iii), dhe 5.02(c)(iii) të Termave dhe Kushteve Standarde, Huamarrësi zhvillon biznesin e tij në pajtim me kërkesën 2 të performancës së BERZH-it.

Seksioni 3.02. Shpeshtësia e raportimit dhe kërkesat e paraqitjes

a) Duke filluar nga data e hyrjes në fuqi, Huamarrësi paraqet raporte periodike për projektin të përmendura në seksionin 4.04(a)(iv) të termave dhe kushteve standarde dy herë në vit, brenda 120 ditëve pas përfundimit të periudhës për të cilën raportohet, deri sa të përfundojë projekti. Këto raporte përfshijnë karakteristikat e mëposhtme specifike:

1) Informacionin e përgjithshëm të mëposh-tëm:

A) ndryshimet kryesore në përbërjen e personelit ose bordin e Huamarrësit;

B) çdo ndryshim në anëtarësinë e një institucioni financiar anëtar;

C) çështjet që mund të ndikojnë në koston ose zbatimin e projektit; dhe çdo zhvillim në lidhje me bashkësponsorizuesit e mundshëm të Projektit;

D) çdo zhvillim ose aktivitet që mund të ndikojë në qëndrueshmërinë ekonomike të Huamarrësit ose të një institucioni financiar anëtar;

E) çdo zhvillim ose aktivitet që mund t'i kërkojë Huamarrësit të paguajë një depozitues të një institucioni financiar anëtar;

F) çdo ndryshim për tarifat e pagueshme Huamarrësit nga një ose të gjitha institucionet financiare anëtare; dhe

G) çdo ndryshim në politikën e investimeve.

2) Hollësitë e pagesave të kryera në përmbushje të detyrimeve të veta kundrejt depozitave të siguruara në pajtim me LDI-në në lidhje me një institucion financiar anëtar, duke iu nënshtruar detyrimeve ligjore të konfi-dencialitetit që rrjedhin nga ligjet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.

3) Një deklarim të shkurtër mbi gjendjen e përputhshmërisë të secilit prej detyrimeve që gjenden në Marrëveshjen e Huas.

4) Një raport, në formë dhe objekt të pranueshëm për BERZH-in, mbi zbatimin nga Huamarrësi të kërkesave 2 të performancës së BERZH-it.

b) Huamarrësi paraqet menjëherë raport për çdo ndryshim të një termi ose dispozite të LDI-së dhe ligjit për bankat dhe ligjit për SCA-në.

c) Në rast se Huamarrësi ka tërhequr një shumë sipas kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi i paraqet Bankës raporte periodike që mund të kërkohen nga Banka herë pas here, në lidhje me përdorimin e fondeve të tërhequra sipas kësaj Marrëveshjeje, shumat që Huamarrësi ka paguar në lidhje me depozitat e siguruara në lidhje me secilën dhe çdo rast sigurimi dhe shumën e plotë të të gjitha depozitave të siguruara në lidhje me një rast sigurimi të paguar dhe/ose që duhet të paguhet, të gjitha në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën.

d) Menjëherë pas ndodhjes së një incidenti që mund të ndikojë në masë të konsiderueshme tek pozicioni financiar i Huamarrësit ose një zhvillimi apo rasti të çdo lloji që i kërkon Huamarrësit të paguajë në përmbushje të detyrimeve të saj kundrejt depozitave të siguruara në pajtim me LDI-në të një institucioni anëtar financiar, Huamarrësi i bën njoftim Bankës nëpërmjet transmetimit me faks, duke specifikuar natyrën e këtij incidenti dhe çdo hap që Huamarrësi po ndërmerr për ta korrigjuar, sipas rastit, në përmbushje të detyrimeve ligjore të Huamarrësit për konfidencialitet që rrjedh nga ligjet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave.

Seksioni 3.03. Detyrime të tjera pohuese të Projektit në lidhje me Garantuesin

a) Huamarrësi i jep Garantuesit një kopje origjinale të nënshkruar të Marrëveshjes së Huas.

b) Huamarrësi njofton Garantuesin për të gjitha kërkesat e bëra nga Huamarrësi për Bankën për disbursime, amendime, heqje dorë ose pëlqime.

Neni 4

Detyrimet financiare dhe operacionale

Seksioni 4.01. Regjistrat dhe raportet finan-ciare

a) Huamarrësi mban në fuqi procedura, regjistra dhe llogari të përshtatshme për të reflektuar, në pajtim me standardet e kontabilitetit të pranuara ndërkombëtarisht dhe të zbatuara në mënyrë të

njëtrajtshme, operacionet dhe gjendjen financiare të Huamarrësit dhe filialeve të tij, sipas rastit, dhe të përshtatshëm për të monitoruar dhe regjistruar përparimin e Projektit (duke përfshirë koston dhe përfitimet e nxjerra prej tij).

b) Huamarrësi:

A) realizon auditimin e regjistrave, të llogarive dhe pasqyrave financiare të tij (duke përfshirë bilancin, pasqyrat e të ardhurave dhe pasqyrën e ndryshimeve në gjendjen financiare dhe shënimet për këtë), dhe regjistrave, llogarive dhe pasqyrave financiare të filialeve të tij çdo vit financiar nga auditë të pavarur në pajtim me IRFS (2) i paraqet Bankës sapo të jetë e disponueshme, por në asnjë rast jo me vonë se katër muaj nga fundi i çdo viti fiskal:

A) kopje të certifikuara të pasqyrave financiare për çdo vit të tillë fiskal të audituar në këtë mënyrë;

B) informacion mbi depozitat e institucioneve financiare anëtare; dhe

C) informacion mbi portofolin e fondeve të disponueshme për Huamarrësin, në rast se Huamarrësit i kërkohet t'u paguajë depozituesve të një institucioni financiar anëtar;

dhe

3) i paraqet Bankës çdo informacion tjetër në lidhje me këto regjistra, llogari dhe pasqyra financiare që Banka mund të kërkojë herë pas here në mënyrë të arsyeshme.

c) Huamarrësi e njofton Bankën në rastin kur Huamarrësi vendos të rrisë/ndryshojë nivelin e mbulimit të sigurimit për depozitues për një shumë mbi 100.000 euro.

Seksioni 4.02. Detyrimet negative

a) Huamarrësi, përveç kur Banka bie dakord ndryshe, nuk ndërmerr asnjë nga veprimet e mëposhtme dhe i paraqet Bankës të gjithë informacionin e nevojshëm që Banka mund ta kërkojë në mënyrë të arsyeshme:

1) lidhja e një marrëveshjeje apo mase për të garantuar ose në një mënyrë apo me kushte të bëhet e detyrueshme për të gjithë ose një pjesë të një detyrimi financiar ose tjetër të një personi tjetër, duke përfshirë një filial ose partner apo institucion financiar anëtar të ndryshëm nga sa kërkohet në pajtim me LDI-në në rastin kur institucioni financiar anëtar nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e veta financiare ndaj depozitave të siguruara;

2) hyrja në një transaksion me një person përveçse në ushtrim të biznesit, sipas termave të zakonshëm tregtare ose mbi bazën e masave të mundësive të zakonshme apo themelimi i një agjencie të vetme ose ekskluzive të blerjeve ose shitjeve, ose hyrja në një transaksion ku Huamarrësi mund të paguajë më shumë se çmimi i zakonshëm tregtar për një blerje ose mund të marrë më pak se çmimi i plotë tregtar i fabrikës (në përputhje me skontot normale tregtare) për produktet ose shërbimet e veta;

3) shitja, dhënia me qira apo disponimi ndryshe i ndonjë prej sendeve të veta pasurore që kërkohet për përmbushjen efiçente të operacioneve të veta apo disponimi i të cilit mund të dëmtojë aftësinë e tij për të përmbushur normalisht ndonjë prej detyrimeve të tij sipas Marrëveshjes së Huas, të ndryshme nga ushtrimi normal i aktivitetit të biznesit kur Huamarrësi kërkon likuiditet me qëllim që të përmbushë detyrimet e tij sipas LDI-së;

4) ndërmarrja ose lejimi i një bashkimi, konsolidimi apo riorganizimi;

5) ulja e tarifave që i paguhen Huamarrësit nga ose të gjitha institucionet financiare anëtare të ndryshime nga ato të parashikuara nga LDI-ja;

6) ndryshimi i nivelit të mbulimit me sigurim për depozitat e çdo shume mbi 100 000 euro;

7) investimi i sendeve pasurore të Huamarrësit të ndryshme nga parashikimi i LDI-së; dhe

8) ndryshimi i politikës së investimeve.

b) Huamarrësi, përveç kur ai njofton Bankën të paktën 30 ditë para, nuk ndërmerr asnjë nga veprimet e mëposhtme dhe i paraqet Bankës të gjithë informacionin e nevojshëm që Banka mund ta kërkojë në mënyrë të arsyeshme:

1) lidhja e një kontrate menaxhimi apo mase tjetër të ngjashme ku biznesi ose operacionet e tij të menaxhohen nga një person tjetër, duke përfshirë një filial apo partner; ose

2) themelimi i një filiali.

c) Huamarrësi nuk jep dhe nuk lejon ekzistencën e huave apo paradhënieve, ose depozitave (përveç depozitave në ushtrim të zakonshëm të biznesit me banka të njohura) me persona të tjerë ose investimet tek një person i caktuar, duke përfshirë një filial ose partner (Investimi); megjithatë, me kusht që Huamarrësi të jetë i lirë të kryejë çdo investim në pajtim me politikën e investimeve (që mund të ndryshojë herë pas here) dhe me kusht që një kopje e saj t'i jepet Bankës.

d) Huamarrësi përfaqëson dhe garanton që angazhimet e mësipërme të Huamarrësit të jenë plotësisht në pajtim me ligjin shqiptar dhe veçanërisht me LDI-në.

Seksioni 4.03. Detyrime të tjera financiare

Pa kufizuar përgjithësimin e seksionit 4.02, Huamarrësi, gjatë të gjithë kohës së periudhës së disponibilitetit të Huas, ruan një raport mbulimi jo më të lartë se 6% e depozitave të siguruara, ku "raport mbulimi" do të thotë raporti i shumës së fondit të Huamarrësit të kompensimit të depozitave (ku ky term është i përkufizuar në ligjin për sigurimin e depozitave) plus shumën e disponueshme të Huas të pjesëtuar me depozitat e siguruara.

Seksioni 4.04. Zhvillimi i biznesit dhe opera-cioneve

Huamarrësi, përveç kur Banka bie dakord ndryshe:

a) E zhvillon biznesin dhe operacionet e tij në pajtim me standardet dhe praktikat e njohura ndërkombëtarisht administrative, financiare, inxhinierike dhe të tjera përkatëse dhe duke marrë parasysh rregullisht politikat kryesore operacionale;

b) Merr menjëherë të gjitha masat brenda kompetencave të veta për të ruajtur ekzistencën e vetë ligjore për të vazhduar operacionet e saj dhe për të përftuar, ruajtur dhe rinovuar të gjitha të drejtat, pronat, kompetencat, privilegjet dhe licencat që janë të nevojshme për të zhvilluar biznesin, duke përfshirë përmbushjen e Projektit;

c) Njofton menjëherë Bankën për çdo propozim për të ndryshuar, pezulluar ose anuluar një dispozitë të statutit dhe i ofron Bankës një mundësi të përshtatshme për të komentuar një propozim të tillë para se të ndërmarrë ndonjë masë për këtë qëllim.

Neni 5

Pezullimi, përshpejtimi, anulimi

Seksioni 5.01. Pezullimi

Sa më poshtë specifikohen për qëllimet e seksionit 7.01(a)(xvii) të Termave dhe Kushteve Standarde:

a) Çdo ndryshim në LDI, ligjin për bankat, ligjin për SCA-në e Republikës së Shqipërisë që mund të ndikojnë negativisht tek operacionet e Huamarrësit, duke përfshirë, por pa u kufizuar te detyrimet potenciale të Huamarrësit dhe renditjen e pretendimeve të Huamarrësit dhe të depozituesve në lidhje me depozitat e siguruara pas ndodhisë së rastit të sigurimit, e ndryshme nga sa është aprovuar nga Banka me shkrim; ose

b) Statuti është ndryshuar, pezulluar, anuluar, shfuqizuar ose hequr dorë prej tij.

Seksioni 5.02. Anulimi nga Huamarrësi

Në rastin e një anulimi nga Huamarrësi, në pajtim me nënseksionin (a) të seksionit 7.02 të Termave dhe Kushteve Standarde, Huamarrësit nuk i kërkohet të paguajë tarifën e anulimit prej një të tetën e një për qind (0,125%) të shumës principale të Huas që anulohet në rast se ky anulim bëhet vetëm për të ruajtur përputhshmërinë me seksionin 4.03 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Seksioni 6.01. Kushtet paraprake për hyrjen në fuqi

Sa më poshtë, specifikohen për qëllimet e seksionit 9.02(c) të Termave dhe Kushteve Standarde si kushte shtesë për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe Marrëveshjes së Garancisë:

a) Marrëveshja e Garancisë do të ratifikohet nga (Këshilli i Ministrave i Qeverisë së Shqipërisë) dhe është në fuqi dhe efekt të plotë.

b) LDI-ja është në fuqi dhe efekt të plotë.

Seksioni 6.02. Opinionet ligjore

a) Për qëllimet e seksionit 9.03(a) të Termave dhe Kushteve Standarde, opinioni ose opinionet e këshilltarëve jepen në emër të Garantuesit kryesisht në formën e grafikut 2.

b) Për qëllimet e seksionit 9.03(b) të Termave dhe Kushteve Standarde, opinioni ose opinionet e këshilltarëve jepen në emër të Garantuesit nga Ministri i Drejtësisë.

Seksioni 6.03. Zgjidhja për shkak të moshyrjes në fuqi

Data, 90 ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje, specifikohet për qëllimet e seksionit 9.04 të Termave dhe Kushteve Standarde.

Neni 7

Të ndryshme

Seksioni 7.01. Njoftimet

Adresat e mëposhtme specifikohen për qëllimet e seksionit 10.01 të Termave dhe Kushteve Standarde:

Për Huamarrësin:

Agjencia Shqiptare e Sigurimit të Depozitave
(Adresa)

Në vëmendje të: (_____)
Faks: (_____)
Teleks: (_____)
Përgjigje: (_____)

Për Bankën:

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
One Exchange Square
London EC2A 2JN
United Kingdom

Në vëmendje të: Njësia e Administrimit të Operacioneve
Faks: +44-20-7338-6100

Në dëshmi të kësaj, palët, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar rregullisht, kanë realizuar nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje në katër koje dhe është shpallur në Tiranë në ditën dhe vitin e shkruar më sipër.

AGJENCIA SHQIPTARE E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Nga: _____
Emri:
Titulli:

BANKA EUROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga: _____
Emri:

Titulli: GRAFIKU 1
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

1. Qëllimi i Projektit është t'i ofrojë Huamarrësit likuiditet dhe të asistojë Huamarrësin për përmbushjen e detyrimeve të veta ligjore që rrjedhin nga një rast sigurimi për të paguar ose transferuar në lidhje me depozitat e siguruara në pajtim me LDI-në në Shqipëri.
2. Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme, në pajtim me ato ndryshime, për të cilat Banka dhe Huamarrësi mund të bien dakord herë pas here:

Pjesa A: Linjë kredie e gatshme prej 100 milionë euro

3. Projekti pritet të përfundohet brenda dhjetorit 2024.

GRAFIKU 2
FORMULARI I OPINIONIT LIGJOR
TË HUAMARRËSIT

(Të shkruhet në kokën e letrës së Huamarrësit)

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
One Exchange Square
London EC2A 2JN
United Kingdom

(Datë)
Zonja dhe zotërinj,

Lënda: Opinion ligjor për Marrëveshjen e Huas ndërmjet (vendosni emrin e plotë ligjor të Huamarrësit siç paraqitet në Marrëveshjen e Huas) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në lidhje me Huan për Projektin (vendosni emrin e Projektit siç paraqitet në Marrëveshjen e Huas).

Në datën (vendosni datën e Marrëveshjes së Huas), Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka) lidhi një marrëveshje huaje (Marrëveshja e Huas) me (vendosni emrin e plotë ligjor të Huamarrësit siç paraqitet në Marrëveshjen e Huas) (Huamarrësi) për të asistuar për financimin e (vendosni emrin e Projektit siç paraqitet në Marrëveshjen e Huas) Projektit (Projekti), duke i dhënë një hua në shumën e (vendosni shumën dhe monedhën e Huas siç shfaqet në Marrëveshjen e Huas).

Në të njëjtën datë, duke patur parasysh që Banka lidhi një Marrëveshje Huaje (vendosni emrin e plotë sovran të anëtarit të BERZH-it siç shfaqet në Marrëveshjen e Garancisë) (Garantuesi) lidhi një marrëveshje garancie (Marrëveshje e Garancisë) me Bankën.

Termat e përkufizuar në Marrëveshjen e Huas përdoren në këtë letër siç përkufizohen në Marrëveshjen e Huas.

Në pajtim me seksionin 9.02(a) të Termave dhe Kushteve Standarde, Marrëveshja e Huas dhe Marrëveshja e Garancisë nuk hyn në fuqi derisa Bankës t'i paraqiten prova, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, që nënshkrimi dhe shpallja e Marrëveshjes së Huas në emër të Huamarrësit është autorizuar ose ratifikuar rregullisht nga veprimet e nevojshme qeveritare ose korporative. Në pajtim me seksionin 9.03(a) të Termave dhe Kushteve Standarde, si pjesë e këtyre provave, Huamarrësit i kërkohet të paraqesë ose të marrë masa për paraqitjen në Bankë të një opinioni ose opinioneve ligjore (në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën), nga këshilltarë të pranueshëm për Bankën, duke treguar ndër të tjera që Marrëveshja e Huas është autorizuar ose ratifikuar rregullisht dhe është nënshkruar dhe shpallur në emër të Huamarrësit dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ligjërisht detyrues të Huamarrësit, të ekzekutueshëm në pajtim me kushtet e

saj.

Në pajtim me seksionin (6.02) të Marrëveshjes së Huas, ky opinion ligjor duhet të paraqitet në emër të Huamarrësit nga (vendosni titullin e nëpunësit që paraqet opinionin).

Në cilësinë time si (vendosni titullin e nëpunësit që paraqet opinionin) i Huamarrësit, unë kam këqyrur kopjen e nënshkruar të Marrëveshjes së Huas dhe të gjithë dokumentacionin tjetër, kam shqyrtuar ato ligje, rregullore, dokumente dhe të tjera dhe kam bërë hetime të tjera që i konsideroj të nevojshme dhe të përshtatshme për qëllimet e këtij mendimi. Bazuar në sa më sipër, unë jam i mendimit dhe deklaroj përkatësisht që:

a) Huamarrësi është themeluar sipas (citoni ligjin, rregulloren, dekretin ose rezolutën përkatëse të Garantuesit që ka themeluar Huamarrësin) dhe ekziston në mënyrë të vlefshme sipas ligjeve të Garantuesit me kompetencën për të marrë detyrime sipas Marrëveshjes së Huas.

b) Më (vendosni datën e rezolutës së organit qeveritar të Huamarrësit që aprovon Marrëveshjen e Huas), (vendosni emrin e plotë të ligjshëm të organit qeveritar të Huamarrësit të autorizuar për të aprovuar Marrëveshjen e Huas) të Huamarrësit, në pajtim me kompetencat e veta bazuar në (citoni dispozitën përkatëse të dokumentit ose ligjit themelues të Huamarrësit që autorizon organin qeveritar të Huamarrësit të aprovojë Marrëveshjen e Huas), vendosi që:

1) teksti i Marrëveshjes së Huas është aprovuar nga Huamarrësi;

2) përmbushja e Marrëveshjes së Huas është autorizuar nga Huamarrësi; dhe

3) (vendosni emrin dhe titullin e përfaqësuesit të Huamarrësit i cili ka nënshkruar Marrëveshjen e Huas) është i autorizuar të nënshkruajë dhe shpallë Marrëveshjen e Huas në emër të Huamarrësit.

c) Bashkëlidhur është një përkthim në përputhje me origjinalin dhe i saktë në gjuhën angleze (citoni rezolutën e organit qeveritar të Huamarrësit që aprovon Marrëveshjen e Huas) që autorizon dhe konfirmon çështjet e përmendura në paragrafin e mësipërm dhe kjo rezolutë është në fuqi të plotë dhe nuk është ndryshuar.

d) Në (vendosni vendin e nënshkrimit të Marrëveshjes së Huas) më (vendosni datën e Marrëveshjes së Huas), Marrëveshja e Huas është nënshkruar dhe shpallur rregullisht (vendosni emrin dhe titullin e përfaqësuesit të Huamarrësit që ka nënshkruar Marrëveshjen e Huas) në emër të Huamarrësit në pajtim me (citoni rezolutën e organit qeveritar të Huamarrësit që ka aprovuar Marrëveshjen e Huas).

Sa më sipër, përfundimi im është që Marrëveshja e Huas është autorizuar ose ratifikuar rregullisht, dhe nënshkruar dhe shpallur në emër të Huamarrësit dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ligjërisht detyrues për Huamarrësin, të ekzekutueshëm në pajtim me kushtet e saj.

Bashkëlidhur janë përkthime të vërteta dhe të sakta në gjuhën angleze të dispozitave përkatëse të (citoni çdo ligj, rregullore, dekret ose rezolutë të Garantuesit dhe rregullore, marrëveshje ose rezolutë të Huamarrësit të përmendur në këtë opinion) mbi bazën e të cilit është dhënë mendimi. Çdo dokument i tillë është në fuqi të plotë dhe nuk është ndryshuar.

Me respekt

(Vendosni emrin dhe titullin e nëpunësit që jep këtë opinion)
(Rendisni shtojcat)

GRAFIKU 3
FORMULARI I KËRKESËS PËR TËRHEQJE

Drejtuar: Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, _____[1]
One Exchange Square
London EC2A 2JN
United Kingdom
Në vëmendje të: Njësia e Administrimit të Operacioneve

Lënda: Marrëveshje huaje, datë ndërmjet Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Agjencisë Shqiptare të Sigurimit të Depozitave dhe Agjencisë Shqiptare për Sigurimin e Depozitave (Huamarrësi).

Monedha dhe shuma e Huas: 100 milionë euro
Numri i operacionit: 45446
Numri i aplikimit: _____

Ne kërkojmë disbursimin e mëposhtëm në llogarinë e specifikuar më poshtë në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Huas të përmendur më sipër:
Monedha e Huas: euro
Shuma e kërkuar[2]: euro _____
Monedha e pagesës: euro_____
Data e vlerës[3]: _____
Udhëzime për pagesën (hollësi bankare):
Emri i llogarisë së marrësit:
_____
Numri i llogarisë së Marrësit:
Emri i Bankës së Marrësit: _____
Adresa e Bankës së Marrësit: _____
Referenca të pagesës (sipas rastit)[4]: _____
Ne specifikojmë dhe përfaqësojmë që:
a) një "Rast i sigurimit" i përkufizuar në LDI ka ndodhur në lidhje me institucionin(et) financiar anëtare më poshtë:
Emri:_____
Data:_____

b) shumat që Huamarrësit i kërkohet të paguajë vlerësohen të jenë:[5]_____
d) ne nuk kemi kërkuar[6] më parë disbursime në lidhje me rastin e mësipërm të sigurimit;
e) të ardhurat nga disbursimi do të zbatohen për Projektin në pajtim me kushtet e Marrëveshjes së Huas;
f) Huamarrësi është në përmbushje të detyrimeve të tij sipas parashikimit në Marrëveshjen e Huas; dhe
g) asnjë rast nuk ka ndodhur, i cili mund të ndikojë negativisht dhe në dëm të gjendjes

[1] *Vendosni datën e kërkesës.*
[2] *Përcaktoni shumën me shifra dhe fjalë.*
[3] *Data që do të debitohet llogaria e BERZH-së*
[4] *Nëse nuk ka, BERZH-i do të specifikojë Emrin e Huamarrësit.*
[5] *Shprehni shumën në shifra dhe fjalë; dhe nëse do të kërkohet të paguhen depozitues drejtpërdrejt apo të transferohen fondet për një blerje dhe prezumimet/banka ndërlidhëse*
[6] *Fshini atë që nuk zbatohet.*

financiare të Huamarrësit ose aftësisë së tij për të përmbushur një prej detyrimeve të tij sipas Marrëveshjes së Huas.

Termat e përkufizuar në Marrëveshjen e Huas kanë këtu të njëjtin kuptim.

Me respekt
Nga dhe në emër të Agjencisë Shqiptare të Sigurimit të Depozitave.
Emri dhe nënshkrimi:_____
Titulli_____
Bashkëlidhur: Numri i plotë i faqeve të përmbledhjes: _____